



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Mbledhja nr. **68/2024**

Data: **14.12.2024. Ora: 12: 00**

Vendi: **Tiranë**

**Kryesues i KQZ-së:** Kreshnik Radoniqi

**Anëtarët e KQZ-së:** Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,  
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

**U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP:** Besnik Buzhala

**Përkthyes:** Jehona Cami

**Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

---

**2. Raport i Këshillave të KQZ**

---

**2.1. Këshilli për Çështje Ligjore**

2.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Pejë

---

---

## **2.2.Këshilli për Personel**

2.2.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesë për furnizim me inventar karrige, orman dhe tavolina pune, kontrata me AQP-në - LOT 2 dhe Lot 3

2.2.2. Shqyrtimi dhe miratimi i Fazes së pestë e rekrutimit të stafit të përkohshëm, pozitat “Monitorues i Fushatës së Zgjedhjeve” (48 pozita) dhe “Zyrtar për Koordinim të Aktiviteteve me Grupe të Margjinalizuara” (1 pozitë);

2.2.3. Shqyrtimi i modaliteteve për shpalljen e pozitave për anëtarë të jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm;

2.2.4. Diskutim për modalitetet e angazhimit dhe kompensimit të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve (KVV dhe Ekipeve Numëruese në QKZ)

---

## **3. Të ndryshme**

---

### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Kryetari Radoniqi, pasqyroi agjendën, ndërsa që anëtarët e KQZ-së e miratuan këtë agjendë.

### **2. Raport i Këshillave të KQZ**

#### **Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Pejë:

Emira Alushi nga Zyra Ligjore, paraqiti në mbledhje kërkesën e kuvendit komunal të Pejës për zëvendësim. Ajo tha se, këshilli ka shqyrtuar kërkesën, dhe se dokumentacioni është procesuar. Janë plotësuar të gjitha kushtet për zëvendësim të asambleistit në këtë komunë.

Si në vijim, znj.Fjolla Dembogaj, rekomandohet nga këshilli që të emërohet anëtare e kuvendit komunal në Pejë, nga subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës”, duke e zëvendësuar anëtaren e kuvendit komunal znj.Xhevahire Çeku Kelmendi.

Me 11 vota për, miratohet ky zëvendësim.

### **Këshilli për Personel**

Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesë për furnizim me inventar karrige, orman dhe tavolina pune, kontrata me AQP-në - LOT 2 dhe Lot 3:

**Alban Krasniqi:** Këshilli për Personel, tha z. Krasniqi ka shqyrtuar këtë kërkesë të bërë lidhur me kërkesën për furnizim me inventar karrige, orman dhe tavolina pune. Kërkesat, kanë ardhur nga njësitë brenda administratës. Ai, tha se, duhet të sillen mostrat paraprakisht në mënyrë që inventari të jetë adekuat me kërkesat. Prandaj, tha Krasniqi, kërkohet që ky rekomandim të miratohet.

Anëtarët e KQZ-së me 11 vota për, miratuan rekomandimin për furnizim me inventar karrige, orman dhe tavolina pune, kontrata me AQP-në - LOT 2 dhe Lot 3.

Shqyrtimi dhe miratimi i Fazës së pestë ( e rekrutimit të stafit të përkohshëm, pozitat “Monitorues i Fushatës së Zgjedhjeve” (48 pozita) dhe “Zyrtar për Koordinim të Aktiviteteve me Grupe të Margjinalizuara” (1 pozitë):

**Alban Krasniqi:** Gjithashtu, këshilli ka shqyrtuar edhe fazën e pestë (5) të rekrutimit të stafit të përkohshëm, pozitat “Monitorues i Fushatës së Zgjedhjeve” (48 pozita), dhe “Zyrtar për Koordinim të Aktiviteteve me Grupe të Margjinalizuara” (1 pozitë). Gjithsej, 49 pozita. Këshilli prandaj, rekomandon miratimin e rekrutimeve.

Në këtë pikë, diskutuan dhe shtruan pyetje: Fazli Stollaj, Ilir Gashi.

Anëtarët e KQZ-së, me 11 vota për miratohet faza e pestë e rekrutimit të stafit të përkohshëm.

Diskutim për modalitetet e angazhimit dhe kompensimit të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve (KVV dhe Ekipeve Numëruese në QKZ):

**Alban Krasniqi:** Ne, i kemi diskutuar çështjet e angazhimit të trupave menaxhuese të zgjedhjeve të KVV-e dhe të ekipeve numëruese në KQZ. Është mirë të shihet shuma e kompenzimit, sidomos për kategoritë që janë në pension dhe mund të angazhohen. Por, atyre kur ju shkon ndonjë e hyrë tjetër, mund të na dalin probleme. Ne, është mirë t'i shkruajmë MEF, në mënyrë që kur ti angazhojmë ata të mos kenë problemi, pavarësisht nëse ata kanë të hyra nga skema sociale. Është mirë që ta dimë paraprakisht, pra, para se stafi të nominohet. Dhe ne, t'i informojmë pastaj partitë politike që ti angazhojnë.

**Adelina Shala,** nga Sekretariati shpjegoi se cilat janë kriteret – shifrat e pagesave sipas kategorive dhe pozitës së angazhuar të këtyre trupave menaxhuese.

Në këtë pikë, shtruan pyetje dhe diskutuan: Ilir Gashi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani.

### **3. Njoftim lidhur me vëzhguesit ndërkombëtarë të zgjedhjeve**

**Valmir Elezi,** zëdhënës i KQZ-së, njoftoi lidhur me interesimin e shprehur nga jashtë për vëzhgimin e zgjedhjeve të 9 shkurtit. Ai tha se, 3 organizata: AËEB, organizata Frankofonia, dhe IFES kanë shprehur vullnetin të jenë në Kosovë. Por, edhe nga Mali i Zi do të kemi vëzhgues. Dhe se, sigurisht që do të ketë komunikim dhe pjesëmarrje nga Shqipëria, Maqedonia etj. Kemi marrë përgjigje pozitive...

Kur jemi te AWEB, tha z. Elezi, jemi shpjeguar se kjo organizatë do t'i njoftoj anëtarët e saj se në Kosovë mbahen zgjedhje (përmes faqes së saj, ose edhe si lajm), dhe ata mund ta shprehin interesimin për pjesëmarrje. Në sekretariat, është duke u hartuar një program për pritjen e vëzhguesve ndërkombëtarë.

Lidhur me këtë pikë, u diskutua në mënyrë interaktive lidhur me kushtet, komunikimet me palët e interesuara, me mundësitë organizative të pritjes, çështjet e akomodimit etj.

Në fund, u shqyrtua nevoja që të formohet një grup brenda Sekretariatit që, do të merret me organizimin dhe protokollin e pritjes së vëzhguesve të huaj.